

S T A T U T I

(I SHOQERISE ME PËRGJEGJESI TE KUFIZUAR SHPK)
E m e r t u a r

- SHOQERIA NDERTIM MONTIMI ELB-NDERTUESI -
E l b a s a n

ARBU I - 1 - re

DISPOZITA TE PËRGJITHESHME

Neni 1.

Shoqeria me përgjegjesi te kufizuar (SHPK) emrohet " Shoqeria Ndertim Montimi Elb Ndertuesi ". Ajo eshte person Juridik Shqiptar, cilesi te cilen e fiten nga momenti i regjistrimit te saj ne gjykatën e rrethit Tirane.

Neni 2.

Aktiviteti i kesaj shoqerie dhe vet ajo bazohen ne legjisla-
cionin perkates te Republikes se Shqiprise si dhe dispozitave te statutu-
e te kontrates themelimit te saj.

Neni 3.

Selia e shoqerise me përgjegjesi te kufizuar Elb Ndertuesi
eshte ne lagjen ' 5 maj ' te qytetit Elbasan. Ajo ka te drejte te
themelejoj Dege ose filiale edhe ne qytete dhe rethe te ndryshme te vendi-
dit si dhe jashte teriterit te Republikes se Shqiprise, duke respektuar
edhe legjislacionin e vendit perkates.

Neni 4.

Objekti i veprimterise te kesaj shoqerie eshte:

- NDERTIM TE OBJEKTEVE TE NDRYSHME INDUSTRIALE,
- NDERTIM TE OBJEKTEVE SOCIAL KULTURORE DHE TE INFRASTRUKTU-
RES,
- NDERTIM TE APARTAMENTEVE DHE TE VILAVE TE BANIMIT,
- NDERTIM DHE MONTIME TE KANALIZIMEVE, TE RRUGEVE, te ujsje-
LLSAVE, TE LINJAVE TE TENCIONIT TE LARTE DHE TE ULET,
- PRODHOME TE MATERIALEVE TE NDERTIMIT,
- TRANSPORT TE MALLRAVE DHE TE UDHETARVE,
- NDERTIM TE URAVE DHE TE TUNELEVE,
- KRYERJA E EKSPORT E IMPORT TE MALLRAVE TE NDRYSHME DHE
TRREGTIM MALLRASH ME SHUMICE E PAKICE BRENDIA E JASHTJE VENDIT.

Neni 5.

Pjesemarrja e ortakve ne shoqerin Elb Ndertuesi, nuk i ndalon
ata qe te kene pavarsi ekonomike dhe te drejta per ta patur pasuri dhe
lidhje me shoqeri te tjera jashte saj. Po ashtu shoqeria nuk mer asnjë
detyrim qe buren nga aktiviteti i ortakve te kryera jashte kesaj sho-
qerie. Ortaket ne kete shoqeri jane me cilesi plotesishte te barabar
duke mar përsipën te drejta dhe detyrime te ndersjellta.

TE DREJTAT DHE DETYRAT E ORTAKVE

Neni 6.

Ortakët themelues të shoqërisë kanë këto të drejta kryesore të cilat meren nëpërmjet vendimeve të asamblesë së ortakëve. Nga më kryesoret janë:

- 1- Të marrin pjesë në administrimin e veprimtarisë ekonomike, tregëtare dhe administrative të shoqërisë,
- 2- Të informohen për rezultatet ekonomike të shoqërisë si dhe të kontribuojnë në aritjen e tyre,
- 3- Të kërkojnë dhe marrin informacione të sakta për gjendjen ekonomike financiare të shoqërisë në çdo periudhë kohe të zhvillimit të aktivitetit në shoqëri,
- 4- Të bëjnë propozime për probleme dhe ta paraqesin ato në organin administrativ e kërkojnë të miratohen në asamble,
- 5- Të heqin dorë nga vazhdimi i metejshëm në shoqëri kur e shikojnë të nevojshme duke patur të drejtën për të marrë pjesën e pasurisë që i takon dhe kuotën përkatëse të kapitalit. Po ashtu ka të drejtë të tjetërsojë pasurinë e tij brenda rregullave parashikuara nga kodi civil
- 6- Të kontrollojë veprimtarinë e organit administrativ dhe për parregullsitë të kërkojë analizimin e tyre në asamble,

Neni 7.

Detyrimet kryesore të ortakëve janë:

- Të depozitojnë kuotën e tyre eventuale dhe suplementare në pajtim me statutin dhe kontratën e ortakërisë,
- Të marrin pjesë në administrimin e shoqërisë nëpërmjet organeve të krijuara nga vet ata dhe të japin kontributin personal,
- Të japin shoqërisë të dhënat e domosdoshme për përpunimin dhe aritjen e çdo objekti në shoqëri,
- Të kryejnë detyrat e caktuara duke i raportuar ato në mbledhjen e asamblesë sipas programit të miratuar,
- Të ruajnë pasurinë e përbashkët të shoqërisë dhe sekretin e të dhënave në shoqëri,

Neni 8.

Në rastet kur ortakët kërkojnë të largohen nga vazhdimi i metejshëm në shoqëri e gëzojnë një të drejtë të tillë, me kusht se ka detyrë të njoftojnë ortakun tjetër jo më vonë se një muaj para largimit si dhe ka të drejtë të cedojë pasurinë sipas nenit 6 të statutit duke respektuar kërkesat ligjore të bashkëpunësive.

Neni 9.

Heqja dorë e ortakut nga shoqëria nuk e përjashton atë nga detyrimet që ka shoqëria deri në atë periudhë, detyrime të cilat duhet të dokumentohen.

KUSHTET EKONOMIKE TE SHOQERISE

Neni 10.

Aktiviteti i shoqerise realizohet ne baze te leverdise ekonomike te shoqerise dhe pasqyrohet ne bilancin vjeter dhe periodik te saj.

Neni 11.

Për ta bërë të mundur zhvillimin normal të veprimtarisë, vihet një kapital prej 100.000 njëqindmij leke, i cili shërben si burim fillestar për krijimin e fondit themelor të shoqerise.

Te dy ortakët marrin pjesë në mënyrë të barabartë në krijimin e fondit dhe atë e depozitojnë në bankë.

Neni 12.

Aktiviteti i shoqerise do të vazhdojë për një periudhë kohë prej 20 vjetesh afat që fillon nga data e regjistrimit të shoqerise në gjykatën e rrethit Tiranë.

Neni 13.

Shoqeria është pronare, poseduese, disponuese e tërë pasurisë së saj. Ajo ka të drejtë të blejë, të shfrytëzojë të drejta materiale duke përfshirë dhe të drejtën për të vendosur pasuri në ipoteke dhe marrë kredi bankare.

Neni 14.

E gjithë pasuria e shoqerise garantohej me ligj të shtetit shqiptar, si të gjitha pasuritë shtetërore dhe private. Sigurimi i pasurisë nga ana fizike kryhet nga ortakët sipas vendimeve dhe mënyrave aktuale prej tyre.

Neni 15.

Shoqeria krijon fondin rezervë dhe fondet e tjera të veçanta të cilat shërbejnë për zhvillimin dhe nxitjen e valutës.

Përberja, shumat e përgjithëshme, burimet e këtyre fondeve caktohen nga asamblëja. Po ashtu edhe përdorimi i fondeve vendoset nga asamblëja.

Neni 16.

Shoqeria disponon plotësisht me mjetet e veta financiare. Detyrimet që lindin gjatë aktivitetit të shoqerise mbulohen nga fondin rezervë e fondet e tjera ose nga shumat suplementare që ortakët derdhin gjatë aktivitetit, në rastet kur këto nuk mund të mbulohen nga fondet e caktuara për këtë qëllim.

Neni 17.

Te ardhurat bruto të shoqerise, pasi behen të gjitha zbritjet si çmimi i amortizimit të mjeteve, shpenzimet për paga, mbi paga, sigurime shoqërore, blerje materiale dhe të lendeve të para, karburante e energji elektrike, qera objektësh dhe shpenzime të përgjithëshme, u ndahet ortakëve në mënyrë të barabartë me nga 50 % secilit.

Neni 18.

Bilancet vjetore duhet të paraqiten brenda datës 31 mars të vitit pasardhës nga organi administrativ i cili duhet të miratohet nga asamblëja.

L. 7/68

%

[Signature]

Neni 19.

Veprimtaria financiare e shoqërisë realizohet në bazë të planeve
neve financiare që janë pjesë përberëse e planit unik të saj. Në plane
të financiare parashikohet aktivi dhe pasivi i aktivitetit të shoqërisë.

Neni 20.

Bilancet financiare si dhe llogaria ekonomike mbahen në lekë.
Rezultatet financiare taten në mbështetje të të dhënave të bilancit
vjetor. Shëmbimi i monedhës shqiptare me monedhë të huaj bëhet në
përputhje me kursin e caktuar nga banka e shtetit shqiptar.

KREU I - IV-rt

A D M I N I S T R I M I

Neni 21.

Organi vendimor i shoqërisë është Asambleja e Ortakëve.

Në asamble marrin pjesë ortakët ose të deleguarit e tyre, me të drejtë
votë sipas përqindjes së derdhur në kapitalin themelor.

Asambleja vendos për bilancet vjetore, për ndryshimet në statut, për
shtimin ose pakesimin e kapitalit themelor, për ndryshim objekti në
shoqëri, për emrimin e organit administrativ dhe shkarkimin të tij, po
ashtu përcakton drejtësit kryesore të aktivitetit dhe radhën e venjes
se tyre në veprimtari. Neni 22.

Organi administrativ i shoqërisë emrohet ose rrimrohet nga asam-
bleja e ortakëve. Prepozimi bëhet nga vet ortakët që themelojnë shoqërinë.
Neni 23.

Organi administrativ ka kompetencë për këto vendime:

- Thërrit asamblen e ortakëve duke bërë njoftime 15 ditë më parë,
- Miratën planin dhe llogarit ekonomike mujore dhe tremujore në
kuadrin e planeve tërësore të shoqërisë,
- Bën prepozime të nevojshme në asamble për ndryshime në kapital
lin themelor të shoqërisë kur e shikon të nevojshëm,
- Prepozon dokumentet e nevojshme që do të mbaj shoqëria duke
kërkuar dhe korrëktësin e përpilimit të tyre,
- Prepozon strukturën organizative në shoqëri dhe vendos asamble-
ja,
- Përcakton vendet e punës dhe personat që mund të punësohen, të
cilat i vendos asambleja,
- Prepozon në asamble mënyrën e rregullimit të fondeve, krijimin
burimit, shpërndarjen e detyrimeve, ndarjen e fitimeve,
- Përzgjedh antarët e komisionit të likuidimit që i emron asam-
bleja, - Të kryej veprimtari për likuidimin e llogarive që paraqesin
ortakët në rastet e largimit të njerit ortak nga shoqëria.

Neni 24.

Mardhënjet e punës rregullohen sipas nenit 19 i ligjes 7512
dat 10.08.1991, dhe dispozitave të kudit punës,

Lj/64

%

Stani

KREU I - V - te
MBYLLJA E SHOQERISE

Neni 25.

Veprimtaria e shoqerise pushon sipas propozimit te organit administrativ kur vertetohet rezultat negativ ne bilancet e saj; si dhe kur ortakët jane te mendimit për mbyllje si dhe ne rastet kur parashikohet ne statut. Shoqeria shperndahet ne formen e riorganizimit ose te likujdimit.

Neni 26.

Kur shoqeria likujdohet behen keto veprime?
- Asambleja e ortakëve emron komisionin e likujdimit i cili paraqet bilancin e likujdimit. Shoqeria i jep funde veprimtarise saj ne çastin e miratimit te bilancit te likujdimit.

Pasurit qe jane ven pasi jane ber shlyerjet dhe sistemimi i llogarive, u ndahet te dy ortakëve ne raport me përqindjen ne kapitalin themele te saj derdhur nga çdo ortak.

Pe keshu veprohet edhe ne rastet e likujdimit te degëve ose filialëve te shoqerise. Kompetente eshte asambleja.

Neni 27.

Dispezitat e ketij statuti marin karakter juridik nga momenti i nenshkrimit nga ortakët, vertetimit noterial dhe regjistrimit ne gjykatën e rrethit Tirane.

ORTAKET THEMELUES TE SHOQERISE

Qemal Zyfi

Kapllan Kape

REPUBLIKA E SHQIPRISE
DHOMA E NOTERVE RRETHIT

Nr. 2170 Rept

Nr. _____ Vol.

Elbasan, me 18/10/1995

VERTETIM

Ne qytetin e Elbasanit, sot ne daten 18/10/1995, ne dhemen e noterve para meje Majlinda Lato, notere u paraqiten qytetaret

1- KAPLLAN KAPO, i biri i Hakiut, me vitlindje 1959, lindur e me banim ne Elbasan, inginer, i identifikuar me cecifikaten e tij Nr I6/33, leshuar ne Elbasan,

2- QEMAL ZYEI, i biri i Sejdaliut me vitlindje 1956, lindur e me banim ne Elbasan, inginer, i martuar me later njeftimin AZ Nr 210370, leshuar ne Elbasan, te cilet kerkuan tu behet vertetimi i statutit te tyre për shoqeri tregetare.

Pasi u pa statuti dhe ata e nensharuan ne prenin time behet vertetimi ne pajtim me ligjen per noterin.

NOTERJA

Majlinda Stefi Lato

